



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POLIÇAN
NJESIA E PROKURIMIT**

NR ____ prot.

Poliçan me ____ .04.2026

PROCESVERBAL

**PËR ARGUMENTIMIN E REALIZIMIT TË PROCEDURËS NË NJË KONTRATË
(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)**

**I. OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shërbimi i pastrimit,gjelbërimit,dekorit dhe mirëmbajtjes së varrezave,Bashkia Poliçan
KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
REF-83902-04-30-2026**

Mbjellja e pemëve 77211600-8
Shërbime pastrimi 98341130-5
Shërbime të pastrimit të rrugëve 90611000-3
Shërbime të pastrimit të koshave të plehrave 90918000-5
Kontenierë për mbeturina 44613800-8
Dekorime 45451000-3
Shërbime të mirëmbajtjes së varrezave 98371111-5
Mbjellja dhe shërbimet e mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbra 77310000-6

VLERA E FONDIT LIMIT NË LEKË: 141 946 295 (njqind e dyzete e nje milion e nenteqind e dyzete e gjashte mijë e dyqind e nëntëdhjete e pesë) Monedha, LEK

VLERA E FONDIT LIMIT NË EURO: 1 490 635 (një milion e katërqind e nëtëdhjetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e pese euro pa TVSH ,

Shënim: Konvertimi i monedhës Lekë në Euro është bërë sipas kursit zyrtar të bankës së Shqipërisë
Datë me date 21.04.2026

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 60 muaj.

Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.

Arsyeja kryesore e mosndarjes së procedurës së prokurimit në lote është se referuar preventivit të shërbimit, Autoriteti Kontraktor e ka të pamundur teknikisht ta ndaje këto kontrate në lote të

vecante pasi do duhej qe territori i Bashkise Poliçan te ndahej ne zona gjeografike dhe kjo praktike do te rezultonte jo efektive dhe shume e veshtire per tu menaxhuar.

]

Kjo procedure sherbimi duhet te kryhet nga nje operator ekonomik, pasi lloji i sherbimit per te gene sa me efikas duhet te jete i perqendruar tek nje operator ekonomik . Kryerja nga nje operator ekonomik e ben me efektiv organizmin e punes por sidomos e ben shume me te pershtatshem monitorimin dhe raportimin e te gjitha proceseve te punes qe ky sherbim ka.

Ndarja ne lote do te sillte konfuzion

- vështirësi në koordinimin e operatorëve ekonomikë në të njëjtën hapësirë shërbimi;
- paqartësi në përcaktimin e përgjegjësive në rast mosrealizimi apo cilësie të dobët të shërbimit;
- rritje të kostove administrative dhe të mbikëqyrjes kontraktuale;
- rrezik për mosruajtjen e standardeve të unifikuara të pastrimit, gjelberimit dhe mirëmbajtjes.

Për më tepër, realizimi i kontratës nga një operator i vetëm ekonomik siguron efikasitet më të lartë, ekonomi shkalle dhe standard të njëtrajtshëm shërbimi, në përputhje me parimet e përdorimit me efektivitet

Per keto arsyje AK ka vendosur qe kete procedure ta zhvilloje pa e ndare ne lote.

Nga ana tjeter referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 2 prashikohet shprehimisht se: *“Qëllimi i këtij ligji është:*

- a) të rrisë eficientësinë dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, parashikohet shprehimisht:

1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.
2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.

Referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 14, Operatorët ekonomikë, prashikohet shprehimisht se:

1. Kandidatët ose ofertuesit mund të jenë persona fizikë ose juridikë.
2. Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t’i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje. Autoritetet ose entet kontraktore mund t’u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të

marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës.

Në çdo rast, ky kusht duhet t'u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës.

3. Rregullat për mënyrën e plotësimit të kriterëve nga grupet e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

Në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", Kreu XI, neni 88, është parashikuar:

1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. 3.

Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën "a", të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Referuar sa më sipër legjisllacioni i prokurimit publik njih gjithashtu të drejtën e shoqërive për t'u bashkuar për të përmbushur një kontratë prokurimi, në kushtet kur kjo kontratë nuk mund të realizohet nga një operator ekonomik.

Në rastin konkret, ndarja në lote e procedurës së prokurimit, do të komplikonte menaxhimin dhe shpërndarjen e përgjegjësisë duke e komplikuar realizimin me sukses të kontratës, ndërkohë që në thelb shërbimi është i së njëjtës natyrë.

Kjo bëhet duke mbajtur në konsideratë elemente të tilla si: tregu, konkurrenca e mundshme, vlera e prokurimit, etj., dhe veçanërisht faktin nëse objekti i kontratës është një punë/shërbim/mall për të cilin ofertuesit janë të pakët, kerkon staf teknik, punetore, eksperience dhe organizim të strukturuar. Në këto kushte, duke qënë se kemi të bëjmë me një familje artikujsh të vetëm dhe si i tillë nuk pengon operatorët ekonomikë të marrin pjesë në procedurën objekt prokurimi gjykojmë se realizimi i procedurës në një kontratë të pa ndarë në lote është një veprim i drejtë dhe në përputhje me frymën e legjisllacionit të sipërpërmendur.

Akoma më tej, legjisllacioni me ndryshimet e fundit që ka pësuar ka hequr nevojën për kontratë noteriale por vetem paraqitjen e një kontratë bashkëpunimi ndërmjet operatorëve ekonomik, të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre në qarqe të ndryshme. Në varësi të zërave të shërbimit që do të marrin përsipër të mbulojnë

apo bashkimin e fuqisë punëtore dhe stafit, përcaktohet përqindja e pjesëmarrjes dhe elementët koktrete që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.

Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje Referuar sa më sipër legjislacioni i prokurimit publik e njeh të drejtën e shoqërive për t'u bashkuar për të përmbushur një kontratë prokurimi, në kushtet kur kjo kontratë nuk mund të realizohet nga një operator ekonomik.

Pra duke parë natyrën, specifikat dhe përmasën e këtij shërbimi, mënyrën e operimit të Bashkise Polican qe këtë shërbim e menaxhon nga një strukturë e veçantë e specializuar dhe e strukturuar ne nivele te ndryshme do të përbënte një kosto te shtuar për institucionin tonë copezimi i elementeve te vecante te zerave te preventivit, çka do ta bënte te pa mundur realizimin dhe monitorimin e këtij shërbimi në kostot qe do ti shtoheshin institucionit tonë ndarja ne lote.

KOMISIONI